ALBANIAN DIASPORA COMMUNITIES IN ROMANIA AND TURKEY IN SUPPORT OF THE NATIONAL CAUSE, 1884–1920

(FROM EDUCATIONAL AND CULTURAL ACTIVITIES TO DIPLOMATIC REPRESENTATION)

KOLONITË SHQIPTARE NË RUMANI DHE TURQI NË MBËSHTETJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE 1884–1920

(NGA VEPRIMTARIA ARSIMORE DHE KULTURORE TE PËRFAQËSIMI DIPLOMATIK)

Ilirjana KACELI - DEMIRLIKA

Universiteti I Shkodres "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë
ilirakaceli@gmail.com

Abstrakt

Kumtesa shqyrton veprimtarinë e dy prej kolonive më të rëndësishme të diasporës shqiptare, Rumanisë dhe asaj të Turqisë, përgjatë një periudhe prej afro katër dekadash, nga themelimi i shoqërisë "Drita" në Bukuresht (1884) deri tek mbajtja e Kongresit të Lushnjës (1920). Të dyja kolonitë u organizuan në shoqëri patriotike, që në statutet e tyre deklaroheshin kulturore ose ndihmëtare, por që në thelb kish karakter politik dhe vepruan në mbështetje të çështjes kombëtare. Përbërja shoqërore dhe rrethanat e organizimit u dhanë ide dhe përparësi të ndryshme programeve të tyre. Kolonia e Rumanisë, e krijuar nga emigrantë ekonomikë kryesisht nga Korça, u përqendrua që nga vitet 1880 tek veprimtaria arismore-kulturore si gjuha, libri dhe shkolla shqipe; këtë program e ilustron një letër arkivore e Nikolla Naços e vitit 1888. Në vitet 1912–1914, angazhimi i saj politik u përqendrua tek krijimi dhe mbrojtja e shtetit shqiptar, siç dëshmon edhe shtypi rumun i kohës. Ndërsa kolonia e Turqisë, e përbërë kryesisht nga muhaxhirë të trojeve shqiptare të mbetura jashtë kufijve të vitit 1913, nga nëpunës dhe ushtarakë, e zhvilloi organizimin e saj kryesisht në përfundim të Luftës së Parë Botërore dhe e drejtoi veprimtarinë e saj në mbrojtje të çështjes kombëtare por edhe asaj territoriale. Ky punim argumenton se këto dy koloni dhe rrugët e tyre në dobi të atdheut dhe shqiptaëve u takuan në Konferencën e Paqes në Paris (1919–1920). Në konferencë delegacionet e të dy kolonive vepruan së bashku në mbrojtje të pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të Shqipërisë. Analiza e dhe veprimtaria e tyre mbështetet në dokumentet e Arkivit Qendror të Shtetit të Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në shtypin shqiptar e rumun të kohës dhe në përmbledhjen dokumentare të Stoica Lascu-s.

Fjalë kyçe: *diaspora shqiptare, kolonia e Bukureshtit, kolonia e Stambollit, shoqëria „Drita", Nikolla Naço, Shoqëria Ndihmëtare, pavarësia, Konferenca e Paqes në Paris.*

Abstract

This paper examines the activities of two of the most significant Albanian diaspora communities, those in Romania and Turkey, over nearly four decades, from the establishment of the "Drita" society in Bucharest in 1884 to the Congress of Lushnja in 1920. Both communities organized themselves into patriotic associations whose statutes defined them as cultural or mutual aid societies, although their underlying aims and activities were political and served the Albanian national cause. Differences in their social composition and the circumstances of their organization shaped their respective agendas and priorities. The Albanian community in Romania, established by economic migrants predominantly from Korça, focused from the 1880s onward on educational and cultural initiatives, particularly the promotion of the Albanian language, publications, and schooling. An archival letter written by Nikolla Naço in 1888 illustrates this agenda. Between 1912 and 1914, the community's political engagement centered on the establishment and defense of the Albanian state, as contemporary Romanian newspapers also attest. By contrast, the Albanian community in Turkey, comprising primarily displaced people from Albanian territories excluded from the borders established in 1913, alongside civil servants and military personnel, developed its organizational structures chiefly at the end of the First World War. Its activities focused on defending Albanian national interests and territorial claims. This paper argues that the two communities' distinct approaches to supporting their homeland and fellow Albanians converged at the Paris Peace Conference of 1919–1920, where their delegations worked together to defend Albania's independence and territorial integrity. The analysis draws on documents from the Albanian Central State Archive and the Archive of the Ministry of

Foreign Affairs, contemporary Albanian and Romanian newspapers, and the documentary collection compiled by Stoica Lascu.

Keywords: Albanian diaspora; Bucharest Albanian community; Istanbul Albanian community; Drita Society; Nikolla Naço; Mutual Aid Society; independence; Paris Peace Conference.

1. Hyrje

Në kushtet kur sundimit osman po i vinte fundi dhe më pas kur areali shqiptar do të ishte pjesë e rrezikut të copëtimit të trojeve amtare nga shtetet fqinje, kolonitë e mërgimit përbënin qendra të rëndësishme mbështetjeje për lëvizjen kombëtare. Në Rumani, Bullgari, Egjipt, Shtetet e Bashkuara dhe Turqi, emigrantët shqiptarë gjetën liri organizimi që nuk e kishin në atdhe, dhe e përdorën atë për të mbështetur lëvizjen kombëtare me mjete financiare, botime, shkolla dhe veprimtari diplomatike.
Kjo kumtesë krahason dy koloni me lidhje të hershme ndërmjet tyre, por me rrethana dhe përparësi të ndryshme organizimi. Kolonia e Rumanisë ishte ndër qendrat kryesore të organizimit shqiptar në Ballkan, me një traditë shoqërish kulturore që nis në vitet 1880. Shoqëria Ndihmëtare e kolonisë së Turqisë u zhvillua në fund të Luftës së Parë Botërore, mbi një traditë më të hershme të pranisë dhe të organizimit shqiptar në Stamboll. Pikërisht ky kontrast e bën krahasimin të vlefshëm: ai tregon se si synime dhe tradita të ndryshme mund të çonin në një qëndrim të përbashkët, në momentin kur u vendos fati territorial i Shqipërisë.
Kumtesa ndjek katër drejtime të ndërlidhura. Fillimisht shqyrtohen rrethanat e formimit dhe format e organizimit të dy kolonive. Më tej analizohet raporti midis karakterit kulturor që shoqëritë deklaronin në statutet e tyre dhe veprimtarisë politike që zhvillonin në praktikë. Në vijim trajtohet mënyra se si kolonia e Rumanisë e përjetoi kalimin nga lëvizja kulturore te shteti i pavarur në vitet 1912–1914. Së fundi, vlerësohet bashkëpunimi i të dy kolonive në Konferencën e Paqes në Paris. Burimet kryesore e përdorura në punim kryesisht fondet e Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH) për shoqëritë shqiptare në Rumani (F. 99) dhe në Turqi (F. 101), dokumente të Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ), shtypi i kohës, si dhe përmbledhja e dokumenteve të shtypit rumun për vitet 1912–1914, botuar nga Stoica Lascu.[1]

2. Dy koloni, dy rrugë formimi

2.1. Kolonia e Rumanisë: emigracioni ekonomik dhe shoqëritë kulturore

Pas bashkimit të principatave (1861) dhe fitimit të pavarësisë (1878), Rumania përjetoi një zhvillim ekonomik që tërhoqi fuqi punëtore nga krahinat e Perandorisë Osmane. Emigrantët shqiptarë, kryesisht ortodoksë nga Korça dhe rrethinat e saj, u vendosën në Bukuresht, Brailë, Konstancë e qendra të tjera. Ata kishin tradita të hershme organizimi në korporata zejtarësh e shoqëri bamirësie, ndërsa disa familje, si Geço, Tërpo, Eftimiu dhe Avramidhi-Lakçe, kishin arritur të fitonin pasuri të konsiderueshme.[2]
Shtysa për organizimin kombëtar erdhi nga Shoqëria e Stambollit, e cila në vitin 1881 ngriti në Bukuresht një degë të saj. Më 27 dhjetor 1884, në sallonin “Pomul Verde", u themelua shoqëria e pavarur “Drita", me qëllim kryesor shtypjen e librave shqip dhe hapjen e shkollave shqipe.[3] Presioni i Patrikanës, i konsujve grekë e rusë por dhe kontradiktat e brendshme çuan shpejt në ndarjen e saj. Në janar 1887 u riorganizua shoqëria “Drita" nën drejtimin e Nikolla Naços, ndërsa grupi tjetër që u shkëput krijoi shoqërinë “Dituria". Në vitin 1900 u shtua edhe shoqëria

[1]Stoica Lascu, Independența Albaniei în percepția opiniei publice românești (1912–1914) (Târgoviște: Cetatea de Scaun, 2012).
[2]Ismet Dermaku, *Rilindja Kombëtare shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*, 1983, f. 23–27; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, ASHSH, Tiranë: Toena, 2002, f. 241.
[3]Dermaku, vep. e cit., f. 90; AQSH, F. 99, D. 1, fl. 1 (Statuti i shoqërisë “Drita", 1885).

e studentëve “Shpresa", dhe në dhjetor 1906 të tria u bashkuan në një shoqëri të vetme me emrin “Bashkimi".[4]

Monografia e Ismet Dermakut, e mbështetur në kujtimet e Visar Dodanit dhe në procesverbalet e shoqërisë, i saktëson fazat e para të këtij organizimi. Dega e vitit 1881 u formua në korrik, në shtëpinë e Vasil Tarpos, me nismën e Thimi Markos, Gjergji Geços dhe Visar Dodanit, ndërsa kryetar i saj u zgjodh Anastas Avramidhi-Lakçe. Me kërkesë të drejtuesve të degës, Shoqëria e Stambollit dërgoi në Bukuresht Jani Vreton dhe Pandeli Sotirin për të dhënë udhëzime mbi organizimin e saj.[5] Kuvendi themelues i 27 dhjetorit 1884 u mbajt në praninë e afro 300 shqiptarëve. Kryetar i “Dritës“ u zgjodh tregtari Anastas Avramidhi-Lakçe, nënkryetar tregtari Konstantin Eftimiu, sekretar Gjergji Geço dhe arkëtar Vasil Tarpo. Në pleqësi u përfshi edhe Vahit Abdullah Dibra, si mysliman dhe për lidhjet e tij me ambasadën osmane në Bukuresht. Komiteti mblodhi menjëherë 4.240 lei, nga të cilët 2.000 i dha vetë Avramidhi.[6]

Në një studim të botuar më parë kemi theksuar se një nga faktorët kryesorë të zhvillimit të këtyre shoqërive ishte sigurimi i mjeteve të qëndrueshme të botimit, në radhë të parë i një shtypshkronje të vetën. Vendimi fillestar i “Dritës” për të mbledhur fonde për të hapur një shtypshkronjë dhe botimi i teksteve të para më 1886, ishin të përgatitura nga patriotët dhe intelektualët e Stambollit si Sami e Naim Frashëri dhe Jani Vreto, të cilët krijuan një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet kolonive dhe punuan për plotësimin me tekste dhe nevojave arsimore në Shqipëri. Zgjedhja e alfabetit të Stambollit në statutin fillestar tregon gjithashtu se Bukureshti dhe Stambolli ishin pjesë e një rrjeti kulturor shqiptar shumë kohë përpara bashkëpunimit diplomatik të vitit 1919.[7]

Një dëshmi e gjallë e mënyrës si punonte kjo koloni është letra që Nikolla Naço u dërgoi në fillim të vitit 1888 shqiptarëve të Pitești-t.[8] Në të, ai vlerëson se në Rumani jetonin rreth njëzet mijë shqiptarë dhe argumenton se, po të jepte secili nga një frangë, shoqëria do të mund ta mbushte Shqipërinë, “qytet e katund", me libra shkollorë. Letra e paraqet gjuhën e shkruar si kusht ekzistence, sepse “kombi që e ka gjuhën të shkruar e përpin atë që s'e ka", dhe kërkon që kontributet të mblidhen “pa vënë re besën e miletnë", pra pa dallim feje.[9]

Letra është e rëndësishme edhe për mënyrën se si e shihnin veten shqiptarët e mërgimit. Naço rendit me hidhërim emrat përçmues që u vinin fqinjët: grekët i quanin vëllezër kur kishin nevojë dhe “palo arvanitë" kur u kalonte rreziku; turqit u thoshin “pis arnaut"; në Rumani i ngatërronin me grekë e bullgarë, ose i shanin me shprehjen *capră râioasă*. Përballë kësaj përbuzjeje, ai ngre një panteon historik që shkon nga Pirroja dhe Aleksandri i Madh te Skënderbeu, Ali Pasha dhe heronjtë arvanitë të revolucionit grek, Boçari, Miauli e Griva. Kujtesa e lavdisë nuk shërben si ngushëllim, por si thirrje për veprim: pyetjes se “kush e ka fajin?" ai i përgjigjet “Ne, shqiptarët". Thirrja e tij për një gazetë javore i parapriu botimit të gazetës *Shqiptari*, që Naço e nxori në gusht të po atij viti.[10]

Figura e Naços shfaqet edhe në një burim me natyrë tjetër: monografinë përkujtimore të Lasgush Poradecit, të shkruar në Graz më 13 nëntor 1931 dhe të ribotuar në suplementin “Rilindasi” më 12 gusht 2012. Poradeci e vendos veprimtarinë e tij në lidhjen ndërmjet gjuhës, shkollës, shtypit dhe përpjekjes për ta bërë çështjen shqiptare të njohur në qarqet diplomatike. Në këtë paraqitje, puna kulturore merr kuptim si përgatitje e vetëdijes dhe e veprimit kombëtar.

[4] *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, vep. e cit., f. 242–245; Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar (1878–1912)*, përkth. Skënder Luarasi, Nestor Nepravishta, Tiranë: Phoenix, 2000, f. 141–145. Majlinda Peza-Perriu dhe Ilirjana Kaceli (Demirlika), “Activities of the Albanian Diaspora in Romania in Support of the Albanian National Cause,” Analele Universităţii din Craiova. Istorie XXVII, nr. 2 (42) (2022), 102–104, 109.

[5] Dermaku, vep. e cit., f. 88–89. Sipas Dermakut, disa studime e vendosin formimin e degës në vitin 1880; ai e daton mbledhjen në korrik 1881, duke u mbështetur te V. Dodani dhe Lumo Skëndo.

[6] Dermaku, vep. e cit., f. 90–91. Autori mbështetet te procesverbali i mbledhjes së parë, bashkëngjitur statutit, dhe te kujtimet e V. Dodanit.

[7] Peza-Perriu dhe Kaceli (Demirlika), “Activities of the Albanian Diaspora,” 102–103.

[8] AQSH, F. 99, Dos. 11, viti 1888, f. 1–4.

[9] Peza-Perriu dhe Kaceli (Demirlika), “Activities of the Albanian Diaspora,” 104–105, ku analizohet letra e Naços e vitit 1888.

[10] Skëndi, vep. e cit., f. 145.

Burimi ndihmon të kuptohet edhe mënyra se si brezi i mëvonshëm i intelektualëve shqiptarë e kujtonte dhe e vlerësonte veprimtarinë e kolonisë së Bukureshtit.[11]
Rrëfimi i Poradecit thekson shpenzimin e pasurisë personale të Nikolla Naços për veprimtarinë kombëtare, përgatitjen e mësuesve dhe qarkullimin e librave shqip. Portreti përfundon me imazhin e patriotit që vdes në varfëri. Kjo paraqitje duhet lexuar duke mbajtur parasysh gjuhën lartësuese dhe qëllimin përkujtimor të autorit. Ajo plotëson dokumentet mbi kontributet dhe vështirësitë financiare, por nuk zëvendëson verifikimin e shifrave, datave apo episodeve biografike. Për analizën e kolonive, rëndësia e saj qëndron veçanërisht te modeli i angazhimit personal dhe i përgjegjësisë ndaj bashkësisë që i atribuohet Naços.[12]
Të dhënat që përmbledh Dermaku e nuancojnë këtë portret. Sipas tij, shpenzimet e "Dritës" mbuloheshin kryesisht nga kontributet e punëtorëve dhe të zejtarëve të varfër, ndërsa një pjesë e pasanikëve të kolonisë, si fabrikanti Zhapa, refuzuan të ndihmonin. Në vitin 1889 vetë Naço ndërmori, së bashku me punëtorë shqiptarë, punime publike rreth Bukureshtit, në rregullimin e shtretërve të lumenjve, në kanalizime dhe në ndërtime hekurudhore, për të ushqyer fondin e shoqërisë. Në vitin 1890, me leje të Ministrisë së Brendshme rumune, ai organizoi një llotari me vlerë 50.000 lei, nga e cila arka e shoqërisë përfitoi 6.700 lei.[13] Modeli i angazhimit personal që përshkruan Poradeci gjen kështu mbështetje edhe jashtë rrëfimit përkujtimor, por burimi i tij ishte më shumë puna dhe nisma, sesa pasuria personale.

2.2. Kolonia e Turqisë: muhaxhirët dhe Shoqëria Ndihmëtare

Kolonia shqiptare e Turqisë kishte një origjinë tjetër. Pas Konferencës së Londrës (1913), dhjetëra mijë shqiptarë nga Kosova, Çamëria, Maqedonia Perëndimore dhe Mali i Zi, të mbetur jashtë shtetit shqiptar, u shpërngulën drejt Turqisë. Qeveria xhonturke nuk i la të përqendroheshin në qytetet e mëdha. Me një urdhër të fshehtë të 26 prillit 1914 u ndalua vendosja e tyre në Stamboll dhe Izmir.[14] Më 1 tetor 1915, Talat Pasha urdhëronte që shqiptarët dhe boshnjakët të shpërndaheshin dhe të vendoseshin "jo të bashkuar, por midis popullsisë turke".[15] Pas këtij qëndrimi qëndronte frika e autoriteteve osmane nga karakteri kryengritës i shqiptarëve dhe nga lidhjet e mundshme të tyre me lëvizjen kombëtare. Krahas muhaxhirëve, kolonia përfshinte edhe nëpunës e ushtarakë shqiptarë të administratës osmane, si dhe tregtarë e zejtarë.[16]
Prania shqiptare në Turqi nuk filloi me shpërnguljet pas vitit 1913, por kolonia përfshinte edhe bashkësi të vendosura përpara pavarësisë, të cilat ishin integruar në jetën ekonomike dhe në administratën osmane. Valët e reja të emigrantëve iu shtuan këtij rrjeti të mëparshëm. Kjo vazhdimësi shpjegon se si nevojat e refugjatëve mund të mbështeteshin tek lidhjet dhe përvoja e nëpunësve, ushtarakëve, tregtarëve e zejtarëve shqiptarë. Dallimi me Rumaninë, pra, nuk qëndron te mungesa e një tradite të hershme shqiptare në Stamboll. Ai lidhet si me peshën e grupeve shoqërore, ashtu edhe me rrethanat në të cilat u organizua kolonia.[17]
Situata ndryshoi në vitin 1918, kur amnistia i lejoi emigrantët të vendoseshin edhe në qytetet e mëdha. Më 1 janar 1918, një grup personalitetesh shqiptare në Stamboll ndërmori nismën për themelimin e "Shoqërisë Ndihmëtare të Kolonisë Shqiptare në Turqi". Qëllimi i deklaruar ishte forcimi i lidhjeve midis shqiptarëve dhe ndihma e ndërsjellë për nevojat morale, tregtare e

[11] Lasgush Poradeci, "Për Nikolla Naçon që u varros me këpucë prej karte," Shqiptarja.com, suplementi Rilindasi, 12 gusht 2012, 14–16; tekst i datuar Graz, 13 nëntor 1931, f. 13
[12] Poradeci, "Për Nikolla Naçon," 14–16. Pohimet biografike dhe vlerësimet këtu paraqiten si pjesë e rrëfimit të Poradecit, të ribotuar më 2012.
[13] Dermaku, vep. e cit., f. 103, 122; për llotarinë autori citon S. Jancovici, *Relations roumano-albanaises*, f. 38.
[14]BOA, DH.SNM.33/111, urdhër i fshehtë i 13 Nisan 1330 (26 prill 1914).
[15]BOA, DH.SFR.54-A/357, telegram i 1 tetorit 1915.
[16] Ilirjana Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë dhe marrëdhëniet me Perandorinë Osmane," Studime Sociale" 15, nr. 3 (53) (2021), f. 108–109. Të dhënat për shpërndarjen e emigrantëve dhe përbërjen shoqërore të kolonisë përdoren sipas këtij studimi.
[17] Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 107–109.

shëndetësore. Shoqëria u njoh nga qeveria osmane si organizatë jo politike. Në këshillin e saj administrativ hynë figura si Halil Pashë Gjirokastra (Alizoti), Fuad Bej Dibra, Fuad Pashë Prishtina, Benoit Blinishti dhe At Gjulio Bonati. Gjatë vitit 1919 u hapën degë në Tekirdağ, Edrene, Bursë, Inegöl, Izmir, Aydın e qytete të tjera.[18]

Krahasimi i burimeve lejon të dallohen disa faza të organizimit. Themelimi i Shoqërisë Ndihmëtare kaloi nëpër dy faza të dallueshme: nisma organizative e 1 janarit 1918 dhe kërkesa e 15 marsit 1919, drejtuar Ministrisë së Brendshme Osmane, për njohjen dhe legalizimin e saj. Sipas disa studimeve, data e themelimit të shoqërisë është 15 marsi 1919. Në të vërtetë, të dyja datat i përkasin dy momenteve të ndryshme: e para shënon nismën organizative, ndërsa e dyta procedurën e njohjes zyrtare. Mbetet ende për t'u sqaruar raporti midis teksteve statutore, pasi statuti që ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit ka 54 nene, ndërsa ai që paraqitet në studimet turke ka vetëm shtatë.[19]

Statuti me shtatë nene parashikonte një organizim hierarkik dhe të disiplinuar. Anëtarësimi shoqërohej me një dhurim fillestar dhe me pagesa mujore. Në krye qëndronte një qendër prej 15 anëtarësh, ndërsa në degë drejtimet vendore përbëheshin nga të paktën pesë anëtarë, të zgjedhur me votim të fshehtë. Degët ishin të lidhura ngushtë me qendrën dhe detyroheshin të zbatonin vendimet e saj. Nenet 5 dhe 7 parashikonin përpjekjet për bashkimin me atdheun të krahinave të lëna jashtë kufijve, ruajtjen e lidhjeve kombëtare, ndihmën për nevojtarët dhe mbledhjen e fondeve për propagandë jashtë vendit. Kështu, programi kombëtar shfaqej shprehimisht edhe në tekstin statutor.[20]

Hapja e degëve varej edhe nga marrëdhëniet me administratën osmane. Sipas dokumenteve osmane më 12 maj 1919 Ministria e Brendshme u kërkoi autoriteteve të disa vilajeteve dhe sanxhaqeve të lehtësonin kërkesat e ligjshme për krijimin e degëve. Megjithatë, në İzmit pati kundërshtime ndaj nismëtarit vendor dhe dyshime për lidhjet e tij politike. Rasti tregon se shteti pritës nuk mbante një qëndrim të vetëm: njohja nga qendra mund të shoqërohej me pengesa dhe hetime në nivel vendor.[21]

3. Veprimtaria arsimore dhe kulturore dhe synimet politike të kolonive

Tipari i parë i përbashkët i të dy kolonive është dallimi midis karakterit të deklaruar dhe veprimtarisë reale. Statuti i shoqërisë "Drita", i miratuar në dhjetor 1884, përcaktonte në nenin e dytë se shoqëria nuk do të merrej me politikë, por vetëm me veprimtari kulturore e letrare. Megjithatë, shoqëritë e Bukureshtit u përfshinë shpejt në propagandë politike: nga gazeta *Shqiptari* e Naços, që u drejtohej diplomacive evropiane kundër rrezikut sllav, deri te letrat drejtuar mbretit të Italisë dhe përfaqësuesve austro-hungarezë.[22] Në rastin e Stambollit, emërtimi ndihmëtar shoqërohej me objektiva kombëtarë të shprehur në statutin e shoqërisë. Prandaj karakteri politik i saj nuk mund të shpjegohet vetëm si veprimtari e fshehur pas një profili humanitar.

Teksti i statutit të "Dritës" tregon se ky kufizim kishte arsye praktike. Sipas analizës së Dermakut, mospërzierja në çështjet e brendshme synonte të mbronte familjet e anëtarëve që jetonin ende në Perandorinë Osmane, ndërsa mospërzierja në çështjet e jashtme synonte të shmangte konfliktet me shtete që mund të ndërhynin pranë qeverisë rumune. Megjithatë, statuti

[18]AQSH, F. 101, D. 4, Statuti i Kolonisë shqiptare të Stambollit mbi organizimin e brendshëm të kolonisë dhe degëve të saj. AQSH, F. 101, D. 5, v. 1919. Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 109–111.

[19] Mesut Yavaş, "Mütareke Dönemi'nde İstanbul'da Arnavud Teâvün Cemiyetinin Kuruluşu ve Faaliyetleri," *Vakanüvis Uluslararası Tarih Araştırmaları Dergisi* 8, nr. 1 (2023), 955–957; Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 109–110, veçanërisht fusnotat 5–7. Në artikullin tim të vitit 2021 ka edhe një mospërputhje për riorganizimin: në tekst jepet 3 mars 1919, ndërsa fusnota 6 shënon 3/4/1919; kjo datë nuk përdoret këtu si e verifikuar.

[20] Yavaş, "Mütareke Dönemi'nde," 956–957; autori e paraqet statutin duke iu referuar Tarık Zafer Tunaya-s. Citim i tërthortë.

[21] Yavaş, "Mütareke Dönemi'nde," 958–961, ku analizohen shkresat BOA, DH. EUM. AYŞ. 9/69. Dokumentet arkivore citohen nëpërmjet këtij studimi.

[22]AQSH, F. 99, Dos. 13 dhe 15, viti 1890; Skëndi, vep. e cit., f. 144.

prej 43 nenesh mbështetej në Kanonizmën e Stambollit: ai e bënte osmanishten lëndë fakultative në shkollat shqipe, përcaktonte alfabetin e Stambollit dhe pranonte si anëtarë shqiptarët e krishterë dhe myslimanë të Rumanisë.[23] Pas riorganizimit të janarit 1887, statuti i ri e vendoste shoqërinë madje nën patronazhin formal të sulltan Abdylhamidit. Sipas Dermakut, kjo zgjedhje synonte të mos pengohej shpërndarja e librave dhe hapja e shkollave në Shqipëri, si dhe të lehtësonte qëndrimin kundër grekomanëve.[24]

Kufiri midis profilit kulturor dhe veprimtarisë politike u bë burim tensioni edhe brenda rrjetit të Bukureshtit. Dega e Brailës, e drejtuar nga Joan Feriqide, nxori më 18 maj 1887 gazetën "Drita", programi i së cilës u bënte thirrje shqiptarëve të Rumanisë për bashkim dhe për luftë kundër pushtetit osman. Komiteti Qendror reagoi me një letër të botuar, duke pohuar se gazeta merrej me politikë në kundërshtim me statutin dhe se mund t'u jepte pretekst ndjekjeve kundër shqiptarëve në Perandori; prandaj kërkoi që ajo të pushonte ose të ndryshonte titullin. Braila u përgjigj se gazeta ishte organ personal i redaksisë dhe e mbylli përgjigjen me devizën "luftë kundër shtypësit". Nga numri 3 (1 qershor 1887) gazeta doli me titullin rumun "Lumina" dhe pushoi me numrin 11, më 12 tetor 1887.[25] Episodi tregon se përmbajtja kulturore e statuteve ishte edhe mjet mbrojtjeje, të cilin drejtuesit qendrorë e ruanin me kujdes.

Ndërthurja e veprimtarisë kulturore, ndihmës shoqërore dhe synimeve politike varej nga kushtet e vendit pritës. Në Rumani, organizimi lidhej me interesat e shtetit rumun në Ballkan dhe me çështjen arumune; në Perandorinë Osmane, ai zhvillohej në rrethanat e humbjes së provincave ballkanike dhe të pasojave të luftës. Brenda këtyre kufizimeve, shoqëritë ndërtuan rrjete anëtarësh, siguruan financim dhe zhvilluan programe që ndërthurnin arsimin me mbrojtjen e interesave kombëtarë.

Programet e dy kolonive pasqyronin fazat e lëvizjes kombëtare dhe përbërjen e bashkësive të mërgimit. Kolonia e Rumanisë i përkiste periudhës së Rilindjes, kur problemi kryesor ishte ekzistenca kulturore e kombit. Prandaj prioritetet e saj ishin gjuha, abetarja, gazeta dhe shkolla. Kulmi i kësaj veprimtarie ishte shkolla normale shqipe e Bukureshtit, e hapur më 10 maj 1892 nën drejtimin e Naços. Programi i saj përfshinte mësimin e tri besimeve fetare dhe zhvillohej në tri gjuhë, osmanisht, shqip e rumanisht. Kjo pasqyronte njëkohësisht realitetin osman dhe idealin e bashkimit mbi ndarjet fetare. Shoqëria "Dituria", nga ana e saj, kishte botuar deri në vitin 1901 rreth 25 tituj dhe kishte shpërndarë falas rreth 30 mijë libra.[26]

Programi i gazetës „Shqipëtari", organ i "Dritës", i botuar në numrin e parë më 7 gusht 1888 me titullin "Çfarë kërkojmë", i përmblidhte këto përparësi në katër pika: përdorimin e shqipes në shkolla dhe në kisha, themelimin e degëve dhe hapjen e shkollave, zhvillimin e gjuhës, historisë e letërsisë kombëtare dhe botimin e teksteve, revistave e gazetave shqip. Thirrja drejtuar shqiptarëve pa dallim feje për t'u ngritur "si një trup i vetëm" kundër robërisë i jepte programit përmbajtje politike, edhe pse autonomia administrative kërkohej ende brenda Perandorisë Osmane.[27] Gazeta botohej shqip dhe rumanisht; sipas Dermakut, ajo u shtyp me alfabet latin-rumun me disa përshtatje, ndoshta për mungesë të shkronjave të alfabetit të Stambollit në shtypshkronjë.[28]

Ndihma arsimore e "Diturisë" shkonte përtej botimit të librave: shoqëria i mbështeste financiarisht mësuesit dhe i shpërndante botimet falas, veçanërisht në krahinën e Korçës. Rregullorja e paraqitur në thirrjen e vitit 1901 u ngarkonte anëtarëve edhe shpërndarjen e botimeve dhe mësimin e shqipes për ata që nuk dinin të lexonin e të shkruanin. Ndërkohë,

[23] Dermaku, vep. e cit., f. 92–93; autori citon statutin sipas Arkivave Shtetërore të Bukureshtit, Fondi „Drita", dos. 1, 1885.
[24] Dermaku, vep. e cit., f. 107.
[25] Dermaku, vep. e cit., f. 105–109; autori mbështetet te gazeta "Drita" e Brailës, nr. 1–3 (1887), te Arkivat Shtetërore të Bukureshtit, Fondi „Drita", dos. 2, dhe te studimet e N. Ciachir, G. Maksutovici e V. Bala.
[26] AQSH, F. 99, Dos. 22, viti 1892, f. 3–4. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *Kanunorë të shoqërive shqiptare (1870–1936)*, vëll. I, Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2007, f. 77. Peza-Perriu dhe Kaceli (Demirlika), "Activities of the Albanian Diaspora," 106, 108. Për shkollën, artikulli paraqet programin mësimor; për "Diturinë", numrin e titujve të botuar deri më 1901.
[27] Dermaku, vep. e cit., f. 110, 112; *Shqipëtari* (Albanezul), Bukuresht, nr. 1, 7 gusht 1888.
[28] Dermaku, vep. e cit., f. 120.

shoqëria studentore "Shpresa", e themeluar më 12 shtator 1900, sillte në organizimin e kolonisë një brez të ri. Kërkesat që lidhen me veprimtarinë e saj në vitin 1902 përfshinin shkolla shqipe, përdorimin e shqipes në shërbesat ortodokse dhe amnisti për të burgosurit politikë. Këto tregojnë se puna kulturore dhe kërkesat politike ndërthureshin përpara vitit 1912.[29]
Shoqëria Ndihmëtare e kolonisë së Turqisë e përqendroi veprimtarinë e saj në periudhën pas shpalljes së pavarësisë, kur shteti shqiptar ekzistonte, por ishte i cunguar dhe i kërcënuar. Shumë nga anëtarët e saj vinin pikërisht nga krahinat që ishin lënë jashtë kufijve. Prandaj misioni i delegatëve të saj në Paris u përcaktua si kthimi në "gji të atdheut nënë" i tokave që Konferenca e Londrës i kishte lënë jashtë Shqipërisë. Në një intervistë për gazetën "Petit Parisien", Halil Pasha rendiste "Ulqinin, Plavën, Gucinë, Pejën, Gjakovën, Prizrenin, Prishtinën, Gostivarin, Kërçovën, Dibrën dhe Ohrin" si krahina "plotësisht shqiptare", të banuara nga rreth një milion e gjysmë shqiptarë. Krahas kësaj, shoqëria kishte edhe një funksion social të drejtpërdrejtë: regjistrimin dhe mbrojtjen e muhaxhirëve, veçanërisht pas pushtimit grek të Izmirit në maj 1919, kur ajo kërkoi ndërhyrjen e komisionerëve të Fuqive të Mëdha për shqiptarët e atij qyteti.[30]
Veprimtaria kulturore e shqiptarëve të Stambollit nuk përmblidhej vetëm në Shoqërinë Ndihmëtare. Një rast tjetër dokumentohet nga Frederik Stamati në shkrimin "Enigma e një flamuri". Duke krahasuar flamurin e ruajtur në fondin etnografik të Qendrës së Studimeve Albanologjike me statutin e shoqërisë, autori e lidh mbishkrimin "Rroft Shqipnia 1 Gusht 1919" me fillimin e veprimtarisë së "Shoqërija Djelmoshe" në Kostandinopojë. Sipas dokumenteve që paraqet, një mbledhje e përgjithshme ishte zhvilluar më 26 korrik 1919; statuti përcaktonte datën 1 gusht si fillimin e punës. Flamuri shfaqet kështu si objekt që ruan kujtesën e organizimit të një bashkësie konkrete.[31]
Statuti i cituar nga Stamati parashikonte afrimin e të rinjve, bashkëpunimin në punët e atdheut, përhapjen e gjuhës shqipe dhe të arsimit. Për këto synime shoqëria do të hapte shkolla, do të botonte libra e gazeta dhe do të organizonte konferenca, mësime teorike e praktike, sport e shëtitje. Të ardhurat do të siguroheshin nga kuotat mujore, dhurimet dhe veprimtaritë argëtuese e koncertet; shoqëria paguante edhe mësuesit. Këto dispozita tregojnë se, pas pavarësisë, gjuha dhe shkolla mbeteshin pjesë e programit të shqiptarëve të Turqisë, krahas mbrojtjes territoriale e diplomatike.[32]
Rasti i "Djelmoshës" e bën më të nuancuar krahasimin me Rumaninë: programet e kolonive kishin përparësi të ndryshme, por nuk përjashtonin të njëjtat fusha veprimtarie. Stamati evidenton në dokumente variantet "Djelmosha", "Djelmoshe" dhe "Djelmënija", të cilat i trajton si emërtime të së njëjtës shoqëri. Në këtë kumtesë ajo dallohet nga Shoqëria Ndihmëtare; materiali i gazetës nuk mjafton për të përcaktuar ndonjë varësi organizative ndërmjet tyre. Ndërkohë, bashkimi i veprimtarive arsimore, shoqërore dhe simbolike në statutin e saj dëshmon një fushë më të gjerë mobilizimi kombëtar në Stamboll.[33]

4. Kolonia e Rumanisë dhe mbrojtja e shtetit shqiptar në vitet 1912–1914

Angazhimi politik i kolonisë së Bukureshtit është i dukshëm edhe përpara shpalljes së pavarësisë. Në intervistën e botuar nga "Epoca" më 25 gusht 1912, Pandeli Evangjeli, i paraqitur si nënkryetar i shoqërisë "Bashkimi", e shpjegonte lëvizjen shqiptare në gjuhën e të

[29] Peza-Perriu dhe Kaceli (Demirlika), "Activities of the Albanian Diaspora," 108–109.
[30] AQSH, F. 101, D. 5, procesverbal i kolonisë shqiptare të Stambollit, 1919; AQSH, F. 101, D. 7, v. 1919, f. 77. *Populli*, 3 tetor 1919, nr. 35, f. 3–4. AQSH, F. 101, D. 7, 10 qershor 1919, pika 7.
[31] Frederik Stamati, "Enigma e një flamuri: Zbulohen dokumente për Shoqërinë 'Djelmosha' e Stambollit," Shqiptarja.com, suplementi Rilindasi, 12 gusht 2012, 17.
[32] Stamati, "Enigma e një flamuri," 17, veçanërisht dispozitat e kreut të parë dhe neni 18 mbi burimet e të ardhurave, të transkriptuara në artikull. Statuti përdoret këtu nëpërmjet botimit të Stamatit.
[33] Stamati, "Enigma e një flamuri," 17. Interpretimi i profilit patriotik mbështetet në synimet statutore që citon autori; marrëdhënia institucionale me Shoqërinë Ndihmëtare nuk përcaktohet nga ky burim.

drejtave kushtetuese dhe të barazisë kombëtare. Ai pohonte se shqiptarët kërkonin shkolla në gjuhën amtare dhe njohjen e kombësisë së tyre, duke deklaruar se në atë moment nuk synonin shkëputjen nga Perandoria Osmane. Kjo dëshmi tregon se kalimi drejt pavarësisë nuk duhet paraqitur si një program i pandryshueshëm gjatë gjithë vitit 1912.[34]

Pandeli Evangjeli kundërshtonte gjithashtu paraqitjen e kryengritjes si lëvizje reaksionare ose fetare. Në rrëfimin e tij, mbështetja shqiptare për kushtetutën e vitit 1908 ishte pasuar nga zhgënjimi ndaj politikave xhonturke për arsimin dhe identitetin kombëtar. Duke theksuar solidaritetin e shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë, ai përpiqej ta bënte çështjen shqiptare të kuptueshme për lexuesin rumun si kërkesë për të drejta kombëtare dhe barazi. Intervista dëshmon kështu përdorimin e shtypit të vendit pritës si hapësirë për kundërshtimin e lajmeve që drejtuesit shqiptarë i konsideronin të shtrembëruara.[35]

Një shqetësim tjetër del nga intervista e Hristo Meksit në "Epoca", më 31 gusht 1912: kundërshtimi ndaj sundimit osman shoqërohej me mosbesim ndaj ambicieve territoriale të shteteve fqinje. Meksi i paraqiste shqiptarët si një bashkësi që duhej të mbronte njëkohësisht të drejtat e veta përballë autoriteteve osmane dhe ekzistencën kombëtare përballë fqinjëve. Gjuha e tij polemike duhet lexuar si ndërhyrje politike e kohës. Ajo dëshmon se, në prag të Luftërave Ballkanike, përfaqësues të kolonisë kërkonin ta dallonin çështjen shqiptare nga projektet e zgjerimit të shteteve ballkanike.[36]

Këto intervista e bëjnë më të qartë vazhdimësinë midis veprimtarisë kulturore dhe asaj diplomatike. Shkolla dhe gjuha përbënin kërkesa politike që në verën e vitit 1912; ndryshimi i mëvonshëm lidhej me objektivin shtetëror dhe me mjetet e përfaqësimit. Prania e Evangjelit në debatin publik të vitit 1912 dhe në krye të delegacionit të kolonisë në Paris më 1919 ilustron edhe vazhdimësinë e personelit drejtues. Fragmenti i dokumentit 18, i titulluar në përkthim "Kombi shqiptar", tregon se shtypi rumun diskutonte edhe mundësinë e një Shqipërie autonome; megjithatë, shifrat dhe përkufizimet territoriale që jep ky fragment duhen trajtuar si pjesë e diskursit të kohës.[37]

Shpallja e pavarësisë i dha një drejtim të ri angazhimit politik të kolonisë së Rumanisë. Shtypi rumun i viteve 1912–1914 pasqyron kalimin nga kërkesat për të drejta kombëtare brenda Perandorisë Osmane te mbrojtja e shtetit shqiptar. Në shtator 1912, Asdreni, autori i Himnit Kombëtar dhe banor i Bukureshtit, mendonte ende se pavarësia ishte një ideal i largët dhe se shqiptarët kishin nevojë para së gjithash për qytetërim e kulturë kombëtare, ide që përsëriste pothuajse fjalë për fjalë programin e Naços të vitit 1888. Vetëm pak javë më vonë, ngjarjet e kapërcyen këtë mendim: në tetor 1912 Ismail Qemali erdhi në Bukuresht për të përgatitur një kongres të shqiptarëve dhe kërkoi mbështetjen e qeverisë rumune.[38]

Pas shpalljes së pavarësisë, kolonia u bë një nga zërat më aktivë të diasporës. Më 4 dhjetor 1912, shqiptarët e Bukureshtit festuan me një Te Deum, shenjtëruan flamurin e shtetit të ri dhe miratuan në një tubim publik një rezolutë drejtuar opinionit evropian.[39] Një delegat i tyre, Dhimiter Zografi, kishte qenë dëshmitar okular i kuvendit të Vlorës.[40] Në janar 1913 ata i telegrafuan Edward Grey-t kundër pretendimeve greke mbi Korçën; në shkurt protestuan pranë Fuqive të Mëdha kundër masakrave serbe; në korrik i dorëzuan kryeministrit Titu Maiorescu një memorandum për mbrojtjen e interesave shqiptare në bisedimet e paqes ballkanike.[41] Në

[34] "Evenimentele din Balcani. Ce se petrece în Albania. Convorbire cu vice-președintele Societății «Baskimi» din București", *Epoca*, XVIII, nr. 233, 25 gusht 1912, 1; Lascu, vep. e cit., dok. nr. 16, f. 93–95. Në origjinal emri jepet „Pandele Vanghele", ndërsa shoqëria "Baskimi" është shoqëria „Bashkimi" e Bukureshtit.

[35] Po aty. Pohimet mbi politikat xhonturke paraqiten këtu si qëndrime të të intervistuarit.

[36] "Revoluția din Albania. Convorbire cu d. Hristo Mexi", *Epoca*, XVIII, nr. 239, 31 gusht 1912, 1; Lascu, vep. e cit., dok. nr. 17, f. 95–97.

[37] "De la frații noștri de peste hotare. Neamul albanizesc", në Lascu, vep. e cit., dok. nr. 18, f. 97 e në vijim. Fragmenti përdoret vetëm si dëshmi e debatit publik, jo për të vërtetuar shifra demografike ose kufij etnografikë.

[38] Lascu, vep. e cit., dok. nr. 19, f. 100. Po aty, dok. nr. 21 dhe 24, f. 103–106.

[39] Po aty, dok. nr. 47, f. 137.

[40] Po aty, dok. nr. 52, f. 147.

[41] Po aty, dok. nr. 64, f. 171; nr. 70, f. 180; nr. 88, f. 231.

maj 1914, drejtuesit e kolonisë hodhën poshtë me një letër publike pohimin e një deputeti grek se në jug të Shqipërisë jetonin 200 mijë grekë.[42]
Kulmi i këtij angazhimi ishte mbështetja për princin Wilhelm zu Wied. Në vitin 1914, kolonia festoi ardhjen e tij në Shqipëri me një Te Deum[43] të shërbyer në shqip dhe me telegrame drejtuar mbretit Carol I dhe "mbretit Wilhelm I të Shqipërisë". Kur shteti i ri ra në krizë, në qershor e korrik 1914 shqiptarët e Rumanisë u regjistruan si vullnetarë, krahas vullnetarëve rumunë që shkuan në Durrës, rreth 400 persona gjithsej. Kështu, kolonia që në 1888 mblidhte franga për abetare, në 1914 dërgonte njerëz për të mbrojtur shtetin.[44]
Këto dokumente tregojnë edhe kufijtë e mbështetjes rumune. Shtypi rumun e shihte Shqipërinë shpesh nga këndvështrimi i arumunëve dhe i interesave të Rumanisë në Ballkan; disa autorë propozonin madje një shtet shqiptaro-arumun ose bashkimin e Pindit me Shqipërinë.[45] Kjo ide e kishte zanafillën te programi i Naços për bashkëpunimin me vllehët, por në 1912–1914 ajo u kthye në instrument të politikës rumune. Pas largimit të Wied-it, Nicolae Iorga e shpalli dështimin e shtetit me artikullin "Finis Albaniae" (gusht 1914).[46] Ky zhgënjim i opinionit rumun shpjegon pjesërisht pse, pas luftës, kolonia shqiptare e Rumanisë do të kërkonte mbështetjen e një fuqie të largët, Shteteve të Bashkuara.

5. Vështirësitë dhe përçarjet

Asnjëra koloni nuk ishte e lirë nga konfliktet e brendshme. Në Rumani, ndarja e shoqërisë "Drita" më 1886–1887 pasqyronte jo vetëm ndërhyrjet e jashtme, por edhe dallimin midis shtresës së vjetër e të pasur dhe emigrantëve të rinj, si dhe mosmarrëveshjet për orientimin politik: "Drita" e Naços kërkonte mbështetjen e një fuqie të madhe dhe bashkëpunimin me arumunët, ndërsa "Dituria" mbështetej te forcat shqiptare. Edhe përdorimi i fondeve ishte burim polemikash, siç dëshmon ankesa e Kristoforidhit në vitin 1888 se paratë e mbledhura për fjalorin e tij ishin përdorur për qëllime të tjera.[47]
Procesverbalet e shoqërisë dhe dosja e Gjykatës së Ilfovit, të shfrytëzuara nga Dermaku, e bëjnë më të qartë këtë ndarje. Rryma e Avramidhit dhe e Eftimiut përfaqësonte tregtarët e pasur, ndërsa ajo e Naços mblidhte punëtorët, zejtarët dhe tregtarët e vegjël. Konsulli rus Hitrov dhe silogu grek i Bukureshtit vepruan për ta pasivizuar kryesinë e shoqërisë.[48] Më 2 shkurt 1886 grupi i Naços e shpalli të shpërndarë komitetin dhe në mars, në hotelin "Dacia", zgjodhi një komitet të ri me kryetar Dhimitër Joanidin. Kuvendi vjetor i 4 majit 1886 në :Pomul Verde" u mbajt nën ruajtjen e policisë dhe përfundoi me përleshje; Naço u arrestua dhe u lirua si i pafajshëm nga gjykata më 3 tetor 1886.[49] Riorganizimi i 4 janarit 1887 e vuri në krye të "Dritës" akademikun rumun V. A. Urechia, me nënkryetarë Dimitrie Butculescun dhe Naçon. Ndryshimi i statutit për të pranuar anëtarë joshqiptarë e lidhi shoqërinë më ngushtë me qarqet rumune të interesuara për arumunët. Gjatë prillit 1887 "Drita" hapi degë në Brailë, Fokshan, Konstancë, Mărășești, Krajovë, Ploiesht, Kelerash etj.[50]
Presionet e jashtme nuk vinin vetëm nga Patrikana. Sipas Dermakut, në Bukuresht vepronte edhe një komitet panslavist rreth ambasadorit rus, i cili përpiqej të nxiste përçarje si në "Dritë", ashtu edhe në "Dituri". Në tetor 1888 Naço refuzoi bashkëpunimin me një "Ligë shqiptaro-

[42]Po aty, dok. nr. 130–131, f. 293–294.
[43] **Te Deum** është latinisht dhe vjen nga fjalët e para të një himni të lashtë kishtar, *Te Deum laudamus*, që do të thotë „Ty, o Zot, të lëvdojmë".
[44]Po aty, dok. nr. 108, f. 259; nr. 113, f. 274. Po aty, dok. nr. 145, f. 311; nr. 161, f. 336; nr. 180, f. 363.
[45]Po aty, dok. nr. 25, f. 107; nr. 86, f. 228; nr. 93–94, f. 239–241.
[46]Po aty, dok. nr. 177, f. 360.
[47]AQSH, F. 29 (Kostandin Kristoforidhi), Dos. 11, fl. 1–5. Peza-Perriu dhe Kaceli (Demirlika), "Activities of the Albanian Diaspora," 104–107. Autorët trajtojnë dallimet e orientimit të dy shoqërive dhe ankesën e Kristoforidhit për përdorimin e fondeve.
[48] Dermaku, vep. e cit., f. 95–96.
[49] Dermaku, vep. e cit., f. 96–101; dosja e gjykatës për ngjarjen e 4 majit 1886 ka 318 fletë (Arkivat Shtetërore të Ilfovit, Fondi Tribunali Ilfov, Secția I, dos. 3/1886).
[50] Dermaku, vep. e cit., f. 97, 102–103.

maqedone“ me qendër në Sofje, pas së cilës ai shihte qeverinë bullgare. Kujdesi ndaj Portës kishte, gjithashtu, një arsye praktike: një veprimtari e hapur antiosmane mund të sillte ndërhyrjen e shtetit rumun dhe dëbimin e patriotëve, siç ndodhi më vonë me Dervish Himën dhe Jashar Erebarën.[51]

Në delegacionin e kolonisë së Turqisë në Paris, përçarjet morën trajtë politike. Halil Pasha hyri në konflikt të hapur me delegacionin e qeverisë së Durrësit të kryesuar nga Turhan Pasha, ndërsa takimi i tij i pakonsultuar me Esad Pashë Toptanin në prill 1919 shqetësoi qendrën e Stambollit. Kjo e shtyu këshillin administrativ të dërgonte në Paris Sulejman Delvinën, me detyrë të zgjidhte mosmarrëveshjet dhe të drejtonte delegacionin.[52] Kjo tregon se qendra e kolonisë ruante kontrollin mbi delegatët e saj dhe se synonte një qëndrim të koordinuar me përfaqësuesit e tjerë shqiptarë.

6. Bashkëpunimi i kolonive në Konferencën e Paqes në Paris 1919–1920

Konferenca e Paqes në Paris ishte momenti kur dy rrugët e ndryshme të kolonive u bashkuan. Në Paris shkuan, krahas delegacionit qeveritar të Durrësit, edhe delegacioni i kolonisë së Rumanisë, i kryesuar nga Pandeli Evangjeli, delegacioni i kolonisë së Stambollit, i kryesuar nga Halil Pashë Gjirokastra, si dhe delegatët e Federatës “Vatra" dhe të Partisë Politike në Shtetet e Bashkuara.[53] Vlen të theksohet vazhdimësia personale: Pandeli Evangjeli kishte drejtuar shoqërinë “Dituria" të Bukureshtit që në vitet 1896–1899. Kolonia e Rumanisë sillte kështu në Paris përvojën e tri dekadave të organizimit dhe të angazhimit politik të viteve 1912–1914.[54]

Studimet turke dhe ato shqiptare ndryshojnë pak në datimin e nisjes së delegacionit, por përputhen në thelb. Duke iu referuar gazetës *Alemdar*, Mesut Yavaş-i shënon se një delegacion prej gjashtë vetash u nis nga Stambolli më 8 shkurt 1919. Studimet shqiptare japin datën 7 shkurt, dhe këtë dallim e vëren vetë Yavaş-i në të njëjtën fusnotë. Në të dyja rastet, nisja e delegacionit i paraprin me më shumë se një muaj kërkesës së 15 marsit 1919 për njohjen zyrtare të shoqërisë, të cilën studimi turk e merr si datë themelimi. Vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve ishte marrë që më 30 janar 1919. Rrjedhimisht, mobilizimi për Parisin nisi përpara se shoqëria të njihej zyrtarisht, dhe veprimtaria e kolonisë nuk mund të datohet vetëm nga momenti i kësaj njohjeje.[55]

Bashkëpunimi u shpreh në disa akte të përbashkëta. Në prill 1919, shqiptarët e Rumanisë u bënë thirrje bashkatdhetarëve të Amerikës që të mbështesnin kërkesën për një mandat amerikan, duke argumentuar se Shqipëria kishte nevojë për mbështetjen e një fuqie të madhe, të largët dhe pa interesa territoriale.[56] Më 15 prill 1919, delegatët e kolonive të Turqisë dhe të Rumanisë, së bashku me “Vatrën" dhe Partinë Politike Shqiptare të Amerikës, i dërguan kryesisë së Konferencës një memorandum të përbashkët që denonconte pretendimet italiane mbi Vlorën dhe kërkonte konfirmimin e pavarësisë së plotë të Shqipërisë.[57] Ky dokument dallonte nga qëndrimi më i matur i delegacionit qeveritar ndaj Italisë. Bashkëpunimi vazhdoi me letrën e përbashkët të 4 korrikut 1919[58] dhe kulmoi me protestën e 15 janarit 1920, drejtuar

[51] Dermaku, vep. e cit., f. 113, 118–120. Për letrën e Ligës, të 23 tetorit 1888, autori citon koleksionin e Dh. Polenës në Bukuresht dhe N. N. Naço, *Viitorul românismului în Balcani* (Bukuresht, 1905), f. 59–60.

[52] AQSH, F. 101, D. 7, koncept raporti mbi veprimet e Komitetit qendror të kolonisë; Mehdi Frashëri, *Kujtime*, f. 66.

[53] Parashqevi Qiriazi, „Delegatë në Konferencën e Paqes në Paris", në *Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918–1920*, Tiranë: “Mihal Duri", 1970, f. 39–40.

[54] Hysni Myzyri, *Pandeli J. Evangjeli (1859–1949). Atdhetar dhe burrë shteti i shquar* (Tiranë, 2004), 37–42.

[55] Yavaş, “Mütareke Dönemi’nde,” 964, fusnotat 57–58. Autori krahason Alemdar, 12 shkurt 1919, nr. 1365, 2, me artikullin e Ilirjana Kaceli (Demirlika), “Türkiye’deki Arnavutluk Kolonisi ve Osmanlı İmparatorluğu ile İlişkileri,” Kebikeç 50 (2020): 437.

[56] *Dielli*, Boston, 3 prill 1919, nr. 1489, f. 2.

[57] AMPJ, Fondi MPJ, viti 1919, dos. 18, f. 30–34.

[58] AMPJ, viti 1919, dos. 9, f. 227–228.

Clemenceau-së si kryetar i Konferencës, kundër projektit të Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë. Ajo u nënshkrua nga delegacionet e kolonive të Rumanisë, Amerikës dhe Turqisë.[59] Veprimtaria përfaqësuese e kolonisë zhvillohej njëkohësisht në Paris dhe në Stamboll. Krahas ndjekjes së Konferencës, Komiteti Qendror i Shoqërisë Ndihmëtare mbante takime me përfaqësitë e huaja në kryeqytetin osman. Kjo e zgjeron kuptimin e diplomacisë së kolonisë: delegacioni në Paris mbështetej te një qendër që vazhdonte të ndërmjetësonte me autoritetet dhe me përfaqësuesit diplomatikë në vendin pritës. Bashkëpunimi i kolonive në Paris ishte, pra, pjesë e një veprimtarie më të gjerë për mbrojtjen e interesave shqiptare.[60]
Roli i kolonive nuk mbaroi në Paris. Kongresi i Lushnjës (28–31 janar 1920) hodhi poshtë planin e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë dhe nuk e njohu qeverinë e Durrësit. Në krye të qeverisë së re ai zgjodhi Sulejman Delvinën, i cili pak muaj më parë kishte drejtuar delegacionin e kolonisë së Turqisë në Paris.[61] Me krijimin e qeverisë së re, misioni i delegacioneve të kolonive përfundoi dhe përfaqësimi i Shqipërisë kaloi tek delegatët e caktuar nga Lushnja. Disa nga figurat e kolonisë së Turqisë vazhduan më pas të shërbenin në diplomacinë shqiptare: Fuad Dibra si konsull nderi në Stamboll dhe Benoit Blinishti si përfaqësues pranë Lidhjes së Kombeve.[62]
Përfundimi i mandatit të delegacioneve nuk solli ndërprerjen e veprimtarisë së kolonisë në Turqi. Pas vitit 1920 morën rëndësi më të madhe mbrojtja e bashkatdhetarëve dhe kërkesat për një përfaqësi konsullore të shtetit shqiptar në Stamboll. Këto zhvillime dalin jashtë kufirit kronologjik të kësaj kumtese. Megjithatë, ato ndihmojnë të dallohet mbyllja e një misioni të caktuar diplomatik nga vazhdimësia e organizimit dhe e nevojave të kolonisë.[63]

7. Përfundime

Krahasimi i dy kolonive nxjerr në pah disa përfundime. Së pari, kolonitë shqiptare nuk ishin një realitet i njëtrajtshëm. Përbërja shoqërore, arsyet e emigrimit dhe rrethanat e organizimit ndikuan në përparësitë e tyre. Në Rumani spikati programi arsimor e kulturor i Rilindjes, ndërsa Shoqëria Ndihmëtare në Turqi i kushtoi vëmendje të veçantë mbrojtjes territoriale dhe përfaqësimit diplomatik. Veprimtaria e „Djelmoshës“ dëshmon se arsimi dhe gjuha mbetën pjesë e organizimit shqiptar në Stamboll edhe pas pavarësisë.
Së dyti, pavarësisht këtyre dallimeve, të dyja kolonitë ndanë të njëjtin model organizimi: shoqëri me statut kulturor ose ndihmëtar, me degë në qytetet ku jetonin shqiptarët dhe me financim nga kontributet e anëtarëve. Profili i deklaruar nuk e përjashtonte veprimtarinë kombëtare e politike; përkundrazi, ai shërbente shpesh si mbrojtje ndaj shtetit pritës. Të dyja kolonitë u përballën me presione nga shteti pritës dhe nga fqinjët, si dhe me përçarje të brendshme.
Së treti, vitet 1912–1914 përbëjnë urën midis dy periudhave. Intervistat e gushtit 1912 dëshmojnë se programi kulturor kishte tashmë përmbajtje politike. Pas pavarësisë, kolonia e Rumanisë u angazhua drejtpërdrejt në mbrojtjen e shtetit të ri me rezoluta, memorandume dhe vullnetarë. Por ajo njohu edhe kufijtë e mbështetjes së shtetit pritës, i cili e shihte Shqipërinë përmes interesave të veta. Kjo përvojë ndihmon të shpjegohet pse kolonia e Rumanisë mbështeti në vitin 1919 kërkesën për një mandat amerikan.
Së katërti, Konferenca e Paqes në Paris dëshmoi se, në momentet vendimtare, kolonitë ishin në gjendje t'i kapërcenin dallimet dhe të vepronin së bashku. Memorandumi i 15 prillit 1919 dhe

[59]AQSH, F. Kristo Dako, dos. 7, 15 janar 1920, f. 59–60. Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 111, veçanërisht fusnota 8 për memorandumin e 15 prillit 1919, me referencë te AMPJ, Fondi MPJ, 1919, D. 18, f. 30–34. Këtu dokumenti përdoret nëpërmjet artikullit.
[60] Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 111; aty citohet edhe artikulli "Shqiptarët në Turkie," Populli (1919).
[61]AQSH, F. 101, D. 7, shkurt 1920.
[62] Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 111–112.
[63] Kaceli, "Kolonia Shqiptare e Turqisë," 112–113. Përpjekjet për zyrën e pasaportave dhe përfaqësimin konsullor trajtohen në artikull kryesisht për vitin 1921; ato përmenden këtu vetëm si vijimësi pas periudhës 1884–1920.

protesta e 15 janarit 1920 janë dëshmi e një diplomacie paralele të diasporës, e cila në disa raste qe më e vendosur se delegacioni zyrtar, sidomos në qëndrimin ndaj Italisë. Kalimi i Sulejman Delvinës nga drejtimi i delegacionit të kolonisë së Turqisë në krye të qeverisë së Lushnjës e shpreh qartë lidhjen midis veprimtarisë së kolonive dhe themelimit të shtetit shqiptar të pasluftës.

Bibliografi

Burime arkivore

-Arkivi Qendror Shqiptar (AQSH)

AQSH, F. 99 (Shoqëri shqiptare në Rumani), Dos. 1 (1885); Dos. 11 (1888); Dos. 13 dhe 15 (1890); Dos. 22 (1892).

AQSH, F. 101 (Shoqëritë shqiptare në Turqi), D. 4; D. 5 (1919); D. 7 (1919–1920).

AQSH, F. 29 (Kostandin Kristoforidhi), Dos. 11.

AQSH, F. Kristo Dako, dos. 7 (1920)

-Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ)

AMPJ, Fondi MPJ, viti 1919, dos. 9 dhe 18.

-Başbakanlık Osmanlı Arşivi-(BOA)

BOA, DH.SNM.33/111; DH.SFR.54-A/357.

SHTYPI

DIELLI, Boston, 3 prill 1919.

POPULLI, Shkodër, 8 mars 1919; 3 dhe 9 tetor 1919.

STAMATI, Frederik. "Enigma e një flamuri: Zbulohen dokumente për Shoqërinë 'Djelmosha' e Stambollit." Shqiptarja.com, suplementi Rilindasi, 12 gusht 2012, 17.

PORADECI, Lasgush. "Për Nikolla Naçon që u varros me këpucë prej karte." Shqiptarja.com, suplementi Rilindasi, 12 gusht 2012, 14–16. Tekst i datuar Graz, 13 nëntor 1931.

Referencat

[1] DERMAKU, Ismet. *Rilindja Kombëtare shqiptare dhe kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, 1983.

[2] FRASHËRI, Mehdi. *Kujtime (1913–1933)*. Tiranë: OMSCA-1, 2005.

[3] *HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR*, vëll. II. ASHSH. Tiranë: Toena, 2002.

[4] KACELI, Ilirjana. "Kolonia Shqiptare e Turqisë dhe marrëdhëniet me Perandorinë Osmane." Studime Sociale / Social Studies 15, nr. 3 (53) (2021): 107–115.

[5] LASCU, Stoica. Independența Albaniei în percepția opiniei publice românești (1912–1914). Târgoviște: Cetatea de Scaun, 2012.

[6] MYZYRI, Hysni. *Pandeli J. Evangjeli (1859–1949). Atdhetar dhe burrë shteti i shquar*. Tiranë, 2004.

[7] PEPO, Petraq & Pela, Mihallaq. *Kanunorë të shoqërive shqiptare (1870–1936)*, vëll. I. Tiranë: DPA, 2007.

[8] PEZA-Perriu, Majlinda, dhe KACELI (DEMIRLIKA), Ilirjana. "Activities of the Albanian Diaspora in Romania in Support of the Albanian National Cause." Analele Universităţii din Craiova. Istorie XXVII, nr. 2 (42) (2022): 101–110.

[9] QIRIAZI, Parashqevi. „Delegatë në Konferencën e Paqes në Paris". Në *Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918–1920*. Tiranë: "Mihal Duri", 1970.

[10] *Shoqëritë patriotike shqiptare jashtë atdheut për arsimin e kulturën shqiptare (1879–1912)*. Tiranë: DPA, 1987.

[11] SKËNDI, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar (1878–1912)*. Përkth. S. Luarasi, N. Nepravishta. Tiranë: Phoenix, 2000.

[12] YAVAŞ, Mesut. "Mütareke Dönemi'nde İstanbul'da Arnavud Teâvün Cemiyetinin Kuruluşu ve Faaliyetleri." Vakanüvis Uluslararası Tarih Araştırmaları Dergisi 8, nr. 1 (2023): 947–986. https://doi.org/10.24186/vakanuvis.1259462.